



## **PUBLIKIM I STANDARTIT ISO 9001: 2008**

14/11/2008 - ISO ka publikuar me date 14/11/2008 botimin e ri te standartit ISO 9001: 2008

ISO ka publikuar me date 14/11/2008 botimin e ri te standartit ISO 9001: 2008

Ky botim i ri i standartit nuk permban kushte shtese apo te ndryshme nga i vjetri ISO 9001:2000, por paraqet sqarime mbi pikat ekzistuese, ne drejtim te permiresimit te njetrajtshem te aplikimit dhe te pajtuesmerise se tij me standartin ISO 14001: 2004.

IAF dhe ISO kane rene dakort ne menyre qe tu sigurojne shoqerive te cilat jane te certifikuara ne Sistemin e Administrimit per Cilesine nje kalim sa me te lehte ne Standartin e ri.

Ne fakt eshte vendosur qe nga momenti i publikimit te Standartit ISO 9001: 2008:

- Certifikimet ne perputhje me Standartin ISO 9001:2008 mund t'u leshohen Shoqerive te cilat zoterojne certifikimin, qe pasohen nga nje kontroll mbikeqyres apo ricertifikim i programuar tashme, pergjate se cilit do te verifikohet aplikimi ne standartin e ri.

- Organet e certifikimit, nje vit pas publikimit te standartit te ri (14/11/2009), duhet te leshojne certifikimet e reja, ose ricertifikimet, vetem ne perputhje me ISO 9001: 2008

- Certifikatat ekzistuese ne perputhje me ISO 9001: 2000 do te humbasin vlefshmerine e tyre pas dy vjetesh nga shpallja e standartit ISO 9001: 2008 (14/11/2010).

Gjithashtu eshte e mundur qe pergjate kesaj periudhe dyvjecare te mbeten akoma te vlefshme certifikime ne perputhje me ISO 9001: 2000 nderkohe qe jane leshuar certifikime ne perputhje me standartin e ri.

Per te lehtesuar hyrjen ne standartin e ri, RINA parashikon tu leshoje certifikimin sipas ISO 9001: 2008 Shoqerive tashme te certifikuara qe do te ndiqen nga nje kontroll mbikeqyres apo ricertifikim te parashikuar ne vitin 2009, pa kosto te tjera shtese.

Per te perfituar kete nevojitet qe Shoqerite tashme te certifikuara te verifikojne ne cfare mase standarti i ri mund te influencoje ne Sistemin e Administrimit duke perdorur Apendix B te standartit te ri per identifikimin e modifikimeve, te kontrollojne nese interpretimet e tyre jane te ndryshme nga sqarimet e ofruara nga ISO 9001: 2008 dhe te verifikojne nese eshte e nevojshme marrja e masave korrigjuese ne Sistem per te siguruar perputhjen e plote.

Perfundimet dhe rezultatet e aplikimit te ISO 9001: 2008 do te verifikohen nga RINA pergjate kontrollit te lartpermendur (shihni udhezuesin ISO "udhezuesi permbushes ISO 9001: 2008").

Eshte e rekomandueshme qe Shoqerite qe kerkojne per here te pare certifikimin e Sistemit te Administrimit per Cilesine te adaptojne menjehere Standartin e ri ISO 9001: 2008.